



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 221, Datë 27.12.2016

PËR

**LICENCIMIN E Z. KASTRIOT BEJKOLLARI SI VLERËSUES DËMESH NË
SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 227, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Licencimin e Z. Kastriot Bejkollari, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin, vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës) dhe dëmeve shëndetësore, në këto grupe të Jo-Jetës:**
 - Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit;
 - Sigurime motorrike;
 - Sigurim nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
- 2. Licenca shoqërohet me deklaratën personale të nënshkruar nga vlerësuesi, sipas formatit bashkëlidhur.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI**

DEKLARATË PERSONALE

Unë i nënshkruari, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se në zbatim të nenit 227, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, dhe Ligjit nr.10 076 datë, 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm së sektorin e transportit” të ndryshuar, do të ushtroj veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në mënyrë të pavarur, në përputhje me standartet profesionale dhe do të zbatoj kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurimeve dhe rregullave të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Jam i ndërgjegjshëm dhe pranoj se mos plotësimi i kërkesave të mësipërme mund të jetë subjekt i masave të marra nga Bordi i AMF deri në tërheqjen e licencës.

Me respekt
